

PKR.nr.141/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Suzana Çerkini kryetare, Shpresa Hasaj Hyseni dhe Arben Hoti anëtarë, me zyrtaren ligjore Albulena Ademi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.C. nga P. për shkak të veprës Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, i akuzuar me Aktakuzë të Prokurorisë Themelore, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.776/14 të datës 14.03.2016, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur me data 25.04.2018 dhe 21.05.2018 në prani të prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri dhe të akuzuarit A.C., me datë 22.05.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.C., nga i ati Xh. dhe nëna Sh. e vajzërisë J., i lindur me ... në P. ku edhe jeton në Rr" E.Z." Nr...., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i dy fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ...,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, me datën 13.05.2014 rreth orës 14:50 në Rr" E.Z." në P., me qëllim frikësimi ka përdorë armën të cilën e mbante pa autorizim në atë mënyrë që, pasi paraprakisht ka vërjetur tani të dëmtuarin A.S., i cili ishte duke qëndruar para lokalit të shokut të tij I.M., shkon në shtëpi, merr veturën e tipit Mercedes, ngjyrë e zezë me targa ..., i ofrohet tani të dëmtuarit dhe nga afërsia prej 2-3 metra me revolen e tipit të panjohur shtënë njëherë ku predha e plumbit përfundon në xhepin e tani të dëmtuarit A.S.,

- me këtë ka kryer veprën penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK,

Andaj gjykata, në bazë të neneve 7,17,21,41,42,46,49,50,51,52, 62 par.2.6, 69, 73,74, 75 par.1 pika 1.1 dhe 76 par.1 pika 1.5 të KPRK dhe neneve 357, 359, 365 366 të KPP i shqipton,

DËNIM ME KUSHT DHE ME GJOBË

Ashtu që i përcakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse në afat prej **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **600 € (gjashtëqind) euro**, të cilën gjobë obligohet t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë,

Nëse i akuzuari kryen vepër tjetër penale brenda kohës së verifikimit, atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg në të cilin do t'i llogaritet edhe koha a kaluar në privim lirie,

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, gjykata do t'ia shndërrojë në dënim me burgim duke llogaritur 20 euro për një ditë burgimi,

Gjykata, të akuzuarit gjithashtu i shqipton:

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohen: Fishekë 9x19mm, pa numër serik, precizuara si në vërtetimin mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të gjetura 2014 AC-0680 të datës 13.05.2014,

Obligohet i akuzuari t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **50 (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

A r s y e t i m

Historiku procedurës

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur Aktakuzë PP.nr. 776/14 të datës 14.03.2016 me të cilën ka akuzuar A.C. për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, ka mbajtur shqyrtim fillestar, në të cilin i akuzuari, ndonëse i vënë në dijeni të plotë për pasojat dhe përparësit e pranimit të fajsisë, ka mohuar fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë, andaj i njëjti sipas

udhëzimit të gjykatës në afatin prej 30 ditësh ka parashtruar kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, ndaj të cilës gjykata me datë 16.03.2018 ka nxjerrë aktvendim të veçantë me të cilin ka refuzuar kërkesën e të akuzuarit si të pabazuar dhe, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit ka vazhduar mëtej me procedimin e kësaj çështjeje penale.

Në procedim të çështjes në shqyrtimin kryesor, i akuzuari ka vazhduar të mohojë fajsinë për veprën penale e cilat i vihet në barrë, ndërsa prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka bërë precizimin e kualifikimit ligjor të veprës penale, ashtu që në vend të kualifikimit ekzistues të veprës Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, të akuzuarit ia ka vënë në barrë veprën penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, meqë ka konsideruar se është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Përdorimi i armës me qëllim kërcënimi.

Paraqitja e provave gjatë shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari nuk ka pranuar fajsinë, gjykata në shqyrtimin kryesor, ka vazhduar me procedimin e çështjes penale me administrimin e provave të propozuara përkatësisht me dëgjimin e dëshmitarëve, me shtjellimin e provave materiale dhe dëgjimin e të akuzuarit.

I dëmtuari-dëshmitari A.S. në shqyrtim gjyqësor deklaroi se me datë dhe kohë si në aktakuzë, derisa ishte duke ndejtur dhe biseduar para lokalit të shokut të tij I.M., afër rrugës kryesore në lagjen K., kishte ardhë A.C., me një veturë të tipit Mercedes të zi dhe është ndalë afërsisht 100 metra nga vendi ku të njëjtit kanë qenë ulur, pastaj ka vazhduar t'a drejttojë veturën dhe është afruar në drejtim të tyre, ka hap dritaren e veturës dhe i është drejtuar të dëmtuarit A.S. me të vetmet fjalë “a e din që më ke borxh” dhe në atë moment moment derisa ishin në distancë prej 4-5 metra, i'a ka pa revolen në dorë, thoshte se ishte ngjyrë e zezë, të dy shpejt janë ngritur në këmbë dhe A.C. menjëherë ka fillu me shkrep me revole, ashtu derisa ishte në të kthyer të trupit me qëllim ikjeje, një plumb e ka goditur në kukë, saktësisht në xhepin e pasëm të pantallonave ku edhe e kishte kuletën, ka vazhduar me ikjen dhe është fshehur në shtëpinë e një fqiu, derisa dëshmitari I.M. ka hyrë në shtëpinë e tij. Në vazhdim thekson se pas këtij rasti janë pajtuar pas një jave nëpërmjet ndërmjetësit të quajtur Përparim dhe prej atëherë nuk kanë patur asgjë të keqe, ndërsa plumbin e ka gjetur pas ngjarjes në kuletën që e mbante në pantallona në xhepin prapa dhe ia ka dërguar policisë.

Përndryshe i dëmtuari shpjegon se mes vete kishin patur edhe një mosmarrveshje me të akuzuarin A.C. diku pesë apo gjashtë muaj para ngjarjes që është objekt i kësaj akuze, por edhe atëherë ishin pajtuar me babën e tij, ia kanë falur dhe pas asaj ngjarjeje kurdo që janë takuar nuk kanë folur por nuk kanë pas asgjë të keqe. Në fund i dëmtuari thekson se nuk dëshiron të parashtrijë kërkesë pasurore juridike pasi që tani me ta akuzuarin veç janë pajtuar.

Dëshmitari I.M., deklaroi se ditën kritike derisa qëndronin para lokalit të tij me shokun e tij A.S., me veturë “mercedes” të zi ishte afruar tani i akuzuari A.C. dhe saktë e kjartë e kishte parë me sy të akuzuarin A.C. duke e nxjerrë armën dhe duke e mbajtur dorën brenda në veturë dhe atë në largësi prej 4-5 metrash, siç thotë ishte revole ngjyrë e zezë dhe e kishte dëgjaur të shkrepurën e

armës, paraprakisht e kishte dëgjuar të akuzuarin të ketë thënë “A. më ke një borgj” dhe armën ia kishte drejtuar A.S. i cili në një moment është ngritur në këmbë, ka bërtitur dhe menjëherë të dy ishin larguar nga vendi i ngjarjes për t’u fshehur, thekson se vetë kishte hyrë në shtëpinë e vet, ndërsa A.S. ka vazhduar rrugën në përpjetëze ndërsa i akuzuari A.C. ka kthyer veturën nga prapa. Në fund thekson se ka dëgjuar se i dëmtuari A.S. dhe i akuzuari A.C. janë pajtuar me ndërmjetësime, ndërsa edhe baba i të akuzaurit A.C. ka shkuar tek ai dhe i ka thënë “po më vjen keq që ka ndodhë para shtëpisë tande”, mirëpo nuk ka patur asnjë dëmtim prone.

I akuzuari A.C., në mbrojtjen e vet deklaroi se me këta persona-dëhmitarë nuk ka pasur kurrfarë problemi vetëm se një ditë kur është kthyer nga puna babai i tij i ka thënë të lajmërohet në polici për shkak se e kishin kërkuar. Shton se atë ditë nuk i ka parë dy djemtë A.S. dhe I.M. fare, ndërsa pohon se më herët ka pasur një problem me A.S. dhe janë rrahur mes vete ku i pranishëm nuk ka qenë I.M. por djali i agjës së tij, por pastaj i kanë dërguar njerëz për shkak të konfliktit që kanë pasur për rrahje, por jo edhe për veprën për të cilën akuzohet me këtë aktakuzë. Mirëpo gjatë ballafaqimit me deklarimin e tij të dhënë në polici ku i njëjti me dtë 30.05.2014 kishte deklaruar se të njëjtën ditë derisa shkante në punë me veturë në ndërrimin e dytë në aeroport, dy-tre persona, përkatësisht i akuzuari A.C., I. dhe një person i panjohur tek marketi “B.” iu kishin vërsulur, e kishin sulmuar, duke tentuar ta nxerrin nga vetura por ky ka arritur të ik dhe atë ditë nuk kishte shkuar fare në punë, ndërsa më vonë kishin shkuar policia në shtëpinë e tij për ta kërkuar, arsyeja e sulmit ishte prë shkak se para dy viteve ishte rrahur me A.S., ndërsa në shqyrtim gjyqësor i akuzuari thotë se atë ditë fare nuk i kishte takuar A.S. dhe I., ndërsa për arsyen e ndryshimit të deklaratës nuk jep sqarime prëveq fjalëve siç thotë “diqka në polici duhet me thanë”. Në fund thekson se policia pas këtij rasti e kishte bastisur shtëpinë e tij dhe njëri nga policët në oborrin e shtëpisë së tij e kishte a lënë një fishekë dhe për këtë ishte grindur me djalin e agjes së tij.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit theksoi se bënë rikualifikimin ligjor të veprës penale nga paragrafi 1 në paragrafin 2 të nenit 375 të KPRK dhe i propozon gjykatës që të akuzuarin t’a shapll fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit, meqë me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor në mënyrë të qartë dhe bindëse u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit A.C. manifestohen elementet e veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, i njëjti në mënyrë frikësuese dhe kërcënuese ka përdoruar armën, ndërsa gjendja e tillë faktike është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve A.S. dhe I.M. të cilët në mënyrë identike kanë përshkruar veprimet inkriminuese të të akuzuarit, gjithashtu kjo gjendje faktike u vërtetua edhe nga provat materiale dhe fotodokumentacioni i bashkangjitur shkresave të lëndës, ku shihet vendi ku dëshmitarët kanë qëndruar dhe kuleta ku i kishte mbetur plumbi të dëmtuarit A.S..

I dëmtuar- dëshmitari A.S. ka mbështetur fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit.

I akuzuari A.C. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ndjehet i pafajshëm për veprën penale që I vihet në barrë.

Vlerësimi i provavave materiale

Pas administrimit të tërësishëm të provave në shqyrtimin gjyqësor gjykata vlerësoi secilën provë një nga një dhe, duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin në kuptim të dispozitës së nenit 361 të KPP, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar në aktakuzë, me kualifikim ligjor të precizuar si të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga provat e prezantuara në shqyrtim gjyqësor, si në vijim:

- Nga dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit A.S.
- Nga dëshmia e dëshmitarit I.M.
- Vetëm pjesërisht nga deklarimi i të akuzuarit A.C. në shqyrtim gjyqësor
- Nga leximi i procesverbalit të dëshmisë për konfiskimin e sendeve të datës 13.05.2014,
- Nga Raporti i ekzaminimit balistik të datës 16.07.2014,
- Nga konstatimi i mjekut të datës 13.05.2014 si dhe
- Nga fotodokumentacioni të bashkangjitur në shkresat e lëndës.

Nga provat e lartshënuara, të administruara në shqyrtim gjyqësor gjykata fillimisht vërtetoi faktin e pakontestueshëm se i akuzuari A.C. disa muaj para ngjarjes kritike kishte patur një ngatërresë, ishte rrahur me të dëmtuarin A.S. dhe për këtë i akuzuari A.C. i kishte dërguar njerëz si ndërmjetës dhe ishin pajtuar, këtë fakt e pohojnë të dy, pra i akuzuari dhe i dëmtuari. Kontestuese për gjykatën ishte fakti nëse ditën kritike ishin parë mes veti dhe nëse i akuzuari kishte përdorur armën duek shkrepur në drejtim të të dëmtuarit, andaj gjykata me administrimin e provave të lartshënuara mbetet të vërtetojë ekzistimin e elementeve inkriminuese të të akuzuarit, që e përbëjnë figurën e veprës penale përdorimi i armës nga neni 375 par.2 të KPRK.

Vlerësimi i dëshmive- Nga provat e administruara, gjykata padyshim vërtetoi se i akuzuari ka kryer veprën penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK.

Nga deklarata e të dëmtuarit- dëshmitarit A.S. dhe dëshmitarit I.M., gjykata vërtetoi se ditën kritike i akuzuari A.C. me veturën e tipit Mercedes iu kishte ofruar atyre me veturë dhe nga afërsia iu kishte drejtuar të dëmtuarit A.S. me kanosje “ma ke një borgj” dhe e kishte nrxjerrë revolen me të cilën kishte shkrep në drejtim të tij, me ç’rast plumbi e ka goditur në kukë në anën e pasme të djathë dhe plumbi i ka mbetur në kuletën e tij që e kishte patur në xhep, andaj gjykata të dy deklaratave të tyre ua fali besimin tërësisht, ngase ishin në përputhje të plotë me njëra tjetrin dhe me prova materiale, të njëjtat ishin bindëse, të sinqerta dhe kuptimplotë dhe nuk kishin asnjë kundërthënie as me deklaratimet e tyre të dhëna në fazat e mëhershme të procedurës penale.

Gjykata ia fali besimin deklaratës së të akuzuarit A.C. vetëm pjesërisht, përkatësiht vetëm pjesës së deklaratimit kur i njëjti thekson se babai i tij kishte shkuar me ndërmjetës për t’u pajtuar me A.S., ndërsa pjesës dërmuese të mbrojtjes së tij nuk ia fali besimin, sepse i njëjti duke përmendur rastin e konfliktit të mëhershëm që kishte pasur me A.S. mundohet t’i fshehë veprimet e tija inkriminuese të ndërmarra në ditën kritike dhe atë, sheshazi me qëllim që t’i ikë përgjegjësisë penale, ngase fillimisht deklaratat e tij dhënë në fazën e hetimit dhe në shqyrtim gjyqësor janë kundërthënëse me njëra tjetrin. I akuzuari A.C. akuzohet për veprën penale “Përdorim i armës apo mjetit të

rrezikshëm” se i njëjti ka gjuajtur me armë me qëllim frikësimi të dëmtuarin A.S., ndërsa në deklarimin e tij në polici ka theksuar situatë krejt ndryshe, andaj gjykata e vlerëson mbrojtjen e të akuzuarit si tendencë të tij për t’i ikur përgjegjësis penale, deklaratimet e tija janë konfuze, janë tërësisht kontradiktore meqë fillimisht i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kundërshton asnjë deklaratim të dëshmitarëve qoftë me parashtrim të ndonjë pyetje apo me ndonjë vërejtje në deklaratimet e dëshmitarëve. Gjukata gjithashtu nuk ia fali besimin deklaratimit të tij se fisheku është lënë nga policët para shtëpisë së tij, meqë ky deklaratim nuk është në përputhje me provat tjera nga shkresat e lëndës, përkatësisht askund nuk është konstatuar ndonjë vërejtje nga personat e pranishëm gjatë bastisjes së pronës së të akuzuarit.

Vlerësimi i provave materiale – Nga fotodokumentacioni i bashkangjitur shkresave të lëndës shihet vendi i ngjarjes ku kanë qëndruar dëshmitarët, shihet pamja e kuletës së të dëmtuarit A.S. e cila kishte qenë e shpuar si dhe plumbi që i njëjti e kishte gjetur në kuletë dhe e kishte dërguar në polici.

Nga vërtetimi për marrjen e sendeve të datës 13.05.2014 gjykata vërtetoi se nga i akuzuari A.C. është marrë i njëjti fishekë pa numër serik i gjetur në rrugë përballë shtëpisë së tij, Rr” E.Z.” P..

Nga Raporti i ekspertizës së armëve të zjarrit AKF/2014-2053/2014-1709 të datës 16.07.2014 gjykata ka vërtetuar se në Agjencinë për Forenzikë ishin ekzaminuar dy dëshmi dhe atë, një fishekë i kalibrit 9x119 mm e cila ka mund të jetë e shkrepur nga armët e llojit “Crvena Zastava” dhe një predhë, pjesë e fishekut të kalibrit 9x19 mm, e shkrepur nga arma e kalibrit të njëjtë gjithashtu të llojit “Crvena Zastava”.

Nga raporti mjekësor i datës 13.05.2014 gjykata vlerësoi se i dëmtuari A.S. menjëherë pas ngjarjes përkatësisht në ora 15:15 kishte bërë vizitë mjeksore dhe aty ishte konstatuar se ishte i goditur me armë zjarri në këmbën e djathë ku dhe kishte gërvishje.

Të gjitha provave materiale gjykata ua fali besimin në tërësi, dhe duke qenë si prova të besueshme mbi bazën e të njëjtave gjykata e mbështeti vendimin.

Gjukata, pas vlerësimit të rrethanave të tërësishme dhe pretendimeve të palëve, bazuar në faktet e provat e lartshënuara, konstatoi gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë vërtetë elementet e veprës penale, Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK meqë i akuzuari me dashje kishte përdorur armën me qëllim frikësimi e kërcënimi në ndaj të dëmtuarit andaj, pasi që më parë gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor në drejtim të kësaj veprë penale dhe i shqiptoi dënim të paraparë ligjor të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit, trupi gjykues pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që përcaktojnë llojin dhe lartësisë e dënimit, si rrethanë lehtësuese pati parasysh faktin se i akuzuari është përgjegjës në çdo ftesë të gjykatës, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj në aplikim të dispozitave të zbutjes së dënimit në bazë të nenit 52 par.2 të KPRK, të njëjti i shqiptoi

dënim burgimi, të cilin dënim ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, komfor nenit 75 par.1 pika 1.1 dhe 76 par.1 pika 1.5 të KPRK, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 42 të KPRK dhe në fund, me bindje se i akuzuari në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngajshme.

Gjykata nuk e udhëzoi të dëmtuarin në kontest civilo-juridik, meqë i njëjti në shqyrtim gjyqësor shprehimisht theksoi se nuk dëshiron të parashtojë kërkesë pasurore-juridike.

Vendimin për konfiskimin e sendeve, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 të KPRK lidhur me nenin 375 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par 2 lidhur me 453 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.141/16, me datë 22.05.2018**

**Sekretarja juridike,
Albulena Ademi**

**Kryetarja e trupit gjykues,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.